



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1011/ 2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha, kryesues, Ymer Hoxha dhe Hasan Shala anëtarë, duke vendosur përkritazi për ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Mitrovicë, paraqitur kundër subjekteve politike Aleanca Kosova e Re (AKR) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega Mitrovicë për shkak të parregullsive gjatë ditës së zgjedhjeve për raundin e dytë të zgjedhjeve lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 04.12.2013, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Mitrovicë

Arsyetim

PZAP-i , më datën 02.12.2013, ka pranuar një ankesë nga PDK-ja me të cilën pretendohet se me datën 01.12.2013 gjatë ditës së zgjedhjeve për balotazh për kryetar komune në Mitrovicë kanë ndodhur parregullsi të shumta që kanë ndikuar në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve. Këto parregullsi sipas parashtresës të ankesës kanë pasur të bëjnë me presion ndaj votuesve joshje të tyre për blerje të votave frikësim dhe kërcënim e ku për këto raste është njoftuar Policia e Kosovës dhe Prokuroria e Shtetit dhe se janë hapur këto raste: 2013 BC 1858 2013 BC 18578 2013 BC 1859 2013 BC 1860. Sipas parashtresës të ankese në QV në shkollën fillore Ismail Qemajli në lagjen Bair të Mitrovicës shihen dhe dëgjohen qarte se si aktiviste të AKR-se dhe të LDK-se duke premtuar shpërblime financiare për të votuar

kandidatin e AKR-se për kryetar komune Agim Bahtiri. Këso situatash sipas parashtruesit të ankesë ka pasur në tërë territorin e Mitrovicës para çdo qendre të votimit dhe se këto veprime sipas parashtruesit të ankesë janë në kundërshtim me dispozitat e LZP-se dhe se për këtë arsye kërkojnë që të rivotohet në tërë territorin e Mitrovicës, ndërsa si dëshmi për rastin në fjalë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një audio incizim në CD.

Lidhur me rastin në fjalë PZAP-i kërkoj informacione shtesë nga Policia e Kosovës, ku me këtë rast nga policia e Kosovës ka pranuar raportin e hetuesit me nr 5243 të datës 03.12.2013, përkitazi me rastet e numëruara në raport.

PZAP-i, më datë 03.12.2013 e informoi subjektin politik AKR dhe LDK në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 04.12.2013, në ora 10:00. Sipas afatit të caktuar, PZAP-i, pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik AKR në të cilën deklaroi se ankesa në fjalë është e pabazuar dhe e pa argumentuar nga fakti se subjekti politik AKR në asnjë rast nuk ka bërë presion, frikësim dhe joshje ndaj votuesve për blerje vote por se qytetaret e Mitrovicës kanë qene të lire që të shprehin vullnetin e tyre për të votuar dhe se të gjitha rastet e paraqitura në ditën e zgjedhjeve në Mitrovicë janë sqaruar aty për aty nga ana e policisë në Mitrovicë dhe Prokurorisë dhe se nuk ka asnjë rast i cili është cilësuar si i tillë ashtu siç paraqitet nga PDK-ja.

PZAP-i po ashtu pranoi përgjigjen e kërkuar edhe nga LDK-ja në të cilën theksohet se LDK nuk ka pasur kandidat për raundin e dytë të zgjedhjeve në Mitrovicë dhe se me këtë rast propozon PZAP-i që ta refuzoj ankesën si të pabazuar në objekt dhe si të pa bazë juridike.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore nga ana e PDK-se se në komunën e Mitrovicës ka pasur parregullsi, PZAP-i konstaton se ankesa në fjalë është e pabazuar nga shkak se nga veprimet e ndërmarra dhe provat e administruara, në drejtim të vërtetësisë së shkeljes së pretenduar, si dhe nga audio incizimi i paraqitur si provë nga pala ankuese, nuk mund të vërtetohet autenticiteti i sajë, përkatësisht nuk mund të vërtetohet identiteti i atyre personave të përfshirë në këtë audio incizim. PZAP-i konstaton se me këtë rast nuk është arritur që të vërtetohen pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë. Andaj, në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prandaj, çështja e sipërshtuar nga pala ankuese mund të jetë objekt hetimi e shqyrtimi i institucioneve tjera të ndjekjes, policisë, prokurorisë etj.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr. 1011/2013 më datën 04.12.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.